



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 585 Prot.

Tiranë, më 19.03.2026

V E N D I M

Nr. 61, datë 19 .03. 2026

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”², të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr. 217 Regj, datë 02.10.2025, paraqitur nga ankuesi z. A.K kundër Bashkisë Shkodër, me pretendimin se është diskriminuar për shkak të “aftësisë së kufizuar”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, z. K. , parashtron :

“Unë, A.K, banues në Shkodër dhe përfitues i statusit të invalidit, paraqes këtë ankesë për diskriminim dhe trajtim të padrejtë që më është ushtruar nga Bashkia Shkodër dhe strukturat përkatëse të saj.

Pas daljes nga burgu në vitin 2010, i jam drejtuar ish-kryetarit të Bashkisë Shkodër , z. L.L , me kërkesën për t’u punësuar, duke qenë se gëzoja statusin e invalidit. Si zgjidhje, më është ofruar një hapësirë publike pranë shkollës “Kol Idromeno”, për të vendosur një kioskë për shitjen e gazetave. Ndërtimi i kësaj kioske, si dhe rregullimi i trotuarit përreth, u kryen me shpenzime të mia personale, për të cilat mora kredi bankare. Lidhja elektrike e objektit u bë gjithashtu nga unë, me lejen e bashkisë. Dua të theksoj se vendosja e kioskës ka qenë pjesë e një projekti të vetë bashkisë. Në të njëjtën hapësirë ku u vendos kioska, u vendos edhe tabela e stacionit të autobusit.

Në vitin 2024, për arsye personale lashë një familjar të kujdeset për punën në kioskë, që ajo të mos mbetej e mbyllur. Gjatë kësaj kohe, përfaqësues të bashkisë kontaktuan familjarin tim duke i thënë se kishin ndërmend ta prishnin kioskën. Familjari i sqaroi atyre se objekti është pronë e imja dhe se pagesat e energjisë elektrike kryhen nga unë. Pasi u njoftova për këtë situatë, u paraqita personalisht në bashki për të kërkuar sqarime dhe për të bërë ankesë që objekti të mos prishej. Nënkryetari i

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

bashkisë dhe drejtori i IKMT-së më siguruan verbalisht se nuk do të merrej asnjë masë pa u marrë një vendim zyrtar dhe se do të njoftohesha me shkrim.

Megjithatë, në muajin gusht të këtij viti, në kundërshtim me këto garanci dhe pa u marrë parasysh ankesa ime, kioska u hoq me dhunë policore, me urdhër të dhënë nga drejtori i Policisë Bashkiake, z. Saimir Rrustemi. Ky veprim u krye pa pasur një vendim të dalë nga Bashkia për prishjen ose mosprishjen e objektit dhe pa respektuar procedurat e njoftimit ligjor.

Ky trajtim, përveçse më ka shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale dhe morale, përbën një akt të hapur diskriminimi ndaj meje si person me status invalidi.”

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke parashikuar shprehimisht shkaqet e moshës dhe aftësisë së kufizuar, duke përcaktuar në nenin 1, të tij se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Bazuar në nenin 3, pika 1, të LMD, diskriminimi përcaktohet si : *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 1385/1 prot, datë 16.10.2025, Komisioneri njoftoi dhe kërkoi informacion në lidhje me ankesën nga Bashkia Shkodër në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.
2. Me shkresën nr.22309 prot., datë 30.10.2025, ka kthyer përgjigje Bashkia Shkodër, duke parashtruar :

Fillimisht parashtrorjmë situatën e përgjithshme në lidhje me procesin e lirimit të hapësirave publike, i realizuar me qëllim për t'i kthyer ato në përdorim të gjerë të komunitetit, banorëve të lagjeve të caktuara dhe sidomos hapësirave në shërbim të godinave/teritoreve të shkollave.

Konkretisht nisma e lirimit të hapësirave publike është një nismë ligjore që përfshin të gjithë territorin administrativ të Bashkisë Shkodër, që ka ngushtësisht lidhje me fokusin strategjik të zhvillimit të bashkisë, mbështetur po ashtu në referim të dispozitave ligjore si dhe vendimarrjen e Këshillit të Bashkisë Shkodër nr.45, datë 25.06.2025 “*Për miratimin e rregullores së përdorimit të hapësirës publike në Bashkinë Shkodër*”. Situata faktike aktuale po ashtu provon këtë parashtrim tonin, duke qenë se në fakt, në kuadër të urdhrit për lirimin e hapësirave publike, janë bërë dhjetra ndërhyrje për prishjen e objekteve në hapësira publike, ku deri tani janë hequr 43 kioska, pjesa më e madhe e tyre është hequr në mënyrë vullnetare nga qytetarët. Puna për lirimin e hapësirave publike nuk do të ndërpritet për asnjë moment.

Konfirmojmë për Komisionerin faktin që lirimi i hapësirës duke hequr kioskën objekt i ankesës nuk ka asnjë lidhje me statusin e ankuesit, por është tërësisht veprim i ndërmarrë në funksion të interesit publik.

Bashkia Shkodër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse ka realizuar verifikimet në dokumentacion si dhe situatën në terren sa i takon procesit të lirimit të hapësirave publike zënë nga ambulant, subjekte tregtare, individë, etj. Nga konstatimet tona rezulton se shtetasi A.K me NID G70817054F, ka poseduar një kioskë të vendosur në hapësirë publike, brenda perimetrit të sigurisë së shkollës “Kol Indromeno”, në Bulevardin “Mehmet Pashë Plaku”, ky fakt përbën rrezik për sigurinë e nxënësve të shkollës si dhe bie në kundërshtim me paketën e sigurisë në shkolla. Kioska në fjalë nuk është përdorur për shitje gazetash, siç pretendohet nga poseduesi, por për shitje produktesh ushqimore. Gjithashtu, u konstatua se kioska është dhënë me qira shtetases Gj.D (tregtar ambulant me NIPT L57117196O), e cila e ka përdorur për ushtrimin e aktivitetit të saj tregtar në fushën e shitjes së produkteve ushqimore dhe në pjesën e pasme të kioskës ky shtetas ka bërë një shtesë me material metalik (llamarinë, hekur) në shkelje të lejes së pretenduar nga ana e tij në vitin 2010. Për vërtetimin e gjendjes faktike në terren, vendosen në dispozicion edhe fotografitë përkatëse të kioskës. Për shtetasen Gj.D , Policia Bashkiake ka marrë masa si më poshtë:

- Procesverbal i konstatimit të shkeljes (gjobë) me numër serie 011275, datë 14.11.2023, për ekspozim malli.

- Procesverbal i konstatimit të shkeljes (gjobë) me numër serie 011579, datë 11.03.2024, për zënie të hapësirës publike.
- Akt-konstatimi me numër serie 0001160, datë 18.07.2025, për lirimin e hapësirës publike me afat kohor 5 ditor.
- Procesverbal mbi kundërvajtjen administrative (gjobë) me numër serie 0000013, datë 13.08.2025, për zënie të hapësirës publike që pengon lëvizjen për qytetarët.

Pas prishjes/heqjes së kioskës nga Grupi i Punës për Kontrollin dhe Lirimin e Hapësirave Publike të Bashkisë Shkodër, shtetasi A.K posedues i kioskës mori përsipër pastrimin e vendit nga materialet (hekur, llamarinë etj) me qëllim ruajtjen dhe marrjen e tyre nga ana e tij. Pas mosrespektimit të marrëveshjes së bërë, punonjësit e Policisë Bashkiake kanë konstatuar shkeljen dhe kanë vendosur ndaj shtetasit në fjalë një masë administrative (gjobë).

Procesverbal mbi Kundërvajtjen Administrative (gjobë) me numër serie 0001623, datë 16.08.2025, IV-3.2/1-f për: Kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve, që vënë në rrezik jetën, shëndetin, pronën, apo pronën e të tjerëve përmes mungesës së mirëmbajtjes një njësisë/pronës individuale nga pronari i njësisë, i cili është i detyruar të mirëmbajë njësinë me shpenzimet e veta, vendosjen pa masë sigurie të vazove të luleve apo çdo send tjetër në parvazet e dritareve, ballkoneve, në tarraca apo në çdo pjesë tjetër të mjediseve publike, të përbashkëta apo private. Me mirëmbajtjen e njësisë individuale, asnjë pronar nuk duhet të cenojë, dëmtojë apo rrezikojë pronën e përbashkët apo pronën e ndonjë pronari tjetër.

3. Me shkresën nr.1385/3 prot., datë 11.11.2025, palës ankuese i është komunikuar përgjigja dhe aktet e depozituara nga Bashkia Shkodër. Përgjigja e ankuesit është administruar pranë Komisionerit me nr.1385/4 prot datë 21.11.2025.
4. Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet: *“Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar”*, për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri me shkresën nr. 1385/5 prot., datë 27.11.2025, njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 12.12.2025.

Seanca dëgjimore u zhvillua me pjesëmarrjen e të dy palëve të përfshira në procedurën administrative, ankuesit A.K, i paraqitur personalisht dhe Bashkisë Shkodër, përfaqësuar nga znj. R.Rr, me detyrë specialiste në Drejtorinë Juridike pranë Bashkisë Shkodër, sipas autorizimit nr.25319 prot., datë 10.12.2025.

Gjatë seancës dëgjimore të datës 12.12.2025, pala ankuese paraqiti pretendime të reja në lidhje me shkaqet e pretenduara të diskriminimit, duke shtuar si shkak diskriminues edhe bindjet politike.

Në lidhje me shkakun e bindjeve politike, ankuesi pretendoi se, para se z. B.B , të merrte detyrën si Kryetar i Bashkisë Shkodër ai nuk ka pasur asnjë problematikë. Ankuesi pretendoi se, ka bërë deklaratë të ndryshme publike kundër Kryetarit të Bashkisë Shkodër, z. B.B dhe këto deklaratë kanë shërbyer si bazë për sjelljet e pretenduara diskriminuese ndaj tij.

Ankuesi pretendoi gjithashtu se, ai ka qenë në kushte të ngjashme me kioskën e vendosur tek spitali dhe shkolla e muzikës, të cilat sipas tij nuk janë prishur por vijojnë aktivitetin.

5. Në vijim të seancës dëgjimore, me shkresën nr. 1385 prot., datë 17.12.2025, Komisioneri iu drejtua palës ankuese me një kërkesë për informacion, nëpërmjet të cilës kërkoi nga ankuesi plotësimin e ankesës në lidhje me pretendimin e shtuar gjatë seancës dëgjimore të datës 12.12.2025, me fakte dhe prova mbi të cilat bazohet pretendimi për diskriminim për shkak të bindjeve politike, duke përfshirë, por jo vetëm, fakte dhe prova të cilat provojnë qëndrimet publike të ankuesit kundër Kryetarit të Bashkisë Shkodër z. B.B. Ankuesi nuk e plotësoi ankesën dhe nuk paraqiti asnjë shpjegim, fakt apo provë në lidhje me shkakun e bindjeve politike të pretenduar gjatë seancës dëgjimore të datës 12.12.2025.
6. Në vijim të seancës dëgjimore, me shkresën nr. 1385/8 prot., datë 17.12.2025, Komisioneri kërkoi informacion shtesë në lidhje me ankesën. Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën nr. 969 prot., datë 14.1.2026, Bashkia Shkodër, informoi Komisionerin si vijon:

Grupi i Punës për Kontrollin dhe Lirimin e hapësirave Publike, në zbatim të Urdhërit nr. 851 “Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e gjendjes dhe lirimin e hapësirave publike në territorin administrativ të Bashkisë Shkodër”, ka konstatuar dhe liruar rreth 1000 raste të hapësirave publike të zëna, prej të cilave rreth 750 raste janë shoqëruar me akte konsatimi, ndërsa pjesa tjetër është liruar në mënyrë vullnetare. Në Bashkinë Shkodër janë lënë vetëm 3 (tre) kioska librari, duke nisur nga fakti se tregtojnë libra, deri në një ndërhyrje të mëtejshme.

Raste të ngjashme të kioskave të cilat janë hequr për të njëjtat arsye sikurse në rastin e ankuesi ka patur pranë Shkollës së Muzikës “Prek Jakova”, ku janë hequr dhe liruar hapësirat publike të zëna nga 2 (dy) kioska. Këto kioska sikurse kioska e ankuesit, kanë qenë në perimetrin e sigurisë në shkolla.

Të gjitha kioskat kanë patur një leje vendosje me ose pa afat në vitet e hershme dhe më pas në vite janë pajisur me kontratë dhe kanë hapur niptin, sipas kërkesave të rregulloreve për hapësirat publike. Ndërhyrja për heqjen e tyre është ndërmarrë pasi kanë përfunduar kontratat dhe pasi është miratuar VKB 45/2025 i Bashkisë Shkodër.

Për akt konstatimet në ngarkim të tij, ankuesi ka pasur dijeni ka qenë prezent kur është plotësuar akti por ka refuzuar marrjen dhe ky fakt pasqyrohet në akt-konstatim.

Për sa i përket kioskës të vendosur tek shkolla e muzikës, nuk qëndron pretendimi i ankuesit, pasi janë hequr dhe liruar hapësirat publike të zëna nga 2 (dy) kioskat. Në lidhje me rastin pranë spitalit, poseduesi i kioskës është person me aftësi të kufizuara dhe duke qenë se kjo kioskë nuk ndodhet në perimetrin e sigurisë në shkolla është toleruar përkohësisht deri në gjetjen e një zgjidhjeje ose sistemimi alternativ.

Bazuar në kontratën nr.1897 prot., datë 4.2.2022 me objekt kontrate “Për shfrytëzimin e hapësirave publike për ushtrimin e aktivitetit ambulant”, subjekti që ka ushtruar aktivitetin e tregtarit ambulant është Gj.D , e cila është pajisur edhe me nipt. Nga ana e Bashkisë Shkodër nuk janë miratuar kërkesa për vendosje kioske në hapësirat publike për vitet 2024-2025.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Bazuar në informacionin e administruar gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi se, ankuesi A.K, është i datëlindjes 17.8.1969 dhe është banor i Bashkisë Shkodër. Sipas Librezës së lëshuar nga Shoqata e Invalidëve të Punës të Shqipërisë, ankuesi rezulton person me aftësi të kufizuara, me shkallë invaliditeti të plotë, vlerësim i cili është i vlefshëm për periudhën 31.12.2024 deri më 31.12.2025.

Bazuar në faktet dhe provat të cilat rezultuan gjatë procedurës administrative për shqyrtimin e ankesës, konstatohet se:

Në vitin 2011, bazuar në kërkesën e paraqitur nga ankuesi, Bashkia Shkodër më shkresën nr. 1048 prot., datë 4.4.2011, ka miratuar vendosjen e një kioske shërbimi si gazetashitës ngjitur me Shkollën e Mesme “Kol Idromeno”, në Bulevardin “Mehmet Pashë Plaku”, lagjja “Perash”.

Në muajin Korrik 2025, Bashkia Shkodër ka ndërmarrë nismën për lirimin e hapësirave publike në territorin administrativ të Bashkisë Shkodër, në funksion të fokusit strategjik të zhvillimit të bashkisë, si dhe në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Shkodër nr.45, datë 25.06.2025 “Për miratimin e rregullores së përdorimit të hapësirës publike”. Në këtë rregullore janë përcaktuar kushtet dhe procedura të detajuara për rregullat dhe kushtet e zënies/përdorimit të hapësirave publike në Bashkinë Shkodër.

Në kuadër të kësaj nisme është miratuar me shkresën nr.2774/5 prot., datë 14.07.2025 të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, plan-veprimi i detyrave që do të realizohen nga Policia Bashkiake, për lirimin e hapësirave publike, dhe në vijim, me urdhrin nr.851, datë 15.07.2025, të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, është ngritur grupi i punës për verifikimin e gjendjes dhe lirimin e hapësirave publike në territorin administrativ të Bashkisë Shkodër. Grupi i punës ka detyrë të verifikojë gjendjen dhe lirimin e hapësirave publike ndërsa Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit evidenton, identifikon, bën njoftimin për lirimin e hapësirës publike. Afati i përcaktuar për realizimin e detyrës është data 31.12.2025.

Rezultoni e provuar se, që prej vitit 2022, kioska e pretenduar nga ankuesi i është dhënë për shfrytëzim subjektit Gj.D , me Nipt L57117196O, për një periudhë 1 vjeçare nga data 26.1.2022 deri

më 31.12.2022, fakt ky që rezulton i provuar bazuar në kontratën nr.1879 prot., datë 4.2.2022 “*Për shfrytëzimin e hapësirave publike për ushtrim aktiviteti ambulant*”, lidhur midis këtij subjekti dhe Bashkisë Shkodër. Kjo kontratë është rinovuar edhe për një afat tjetër 1 vjeçar duke filluar nda data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, pasi palët kanë nënshkruar kontratën me nr.2091 prot., datë 10.2.2023. Subjekti Gj.D , me Nipt L57117196O ka vijuar të ushtrojë aktivitetin si ambulant deri në datën 13.8.2025.

Për subjektin Gj.D , me Nipt L57117196O, është mbajtur nga ana e Policisë Bashkiake Shkodër, akt konstatimi nr. 0001160, datë 18.07.2025, nëpërmjet të cilit është urdhëruar lirimi i hapësirës publike brenda afatit kohor 5 (pesë) ditor.

Ky afat nuk është respektuar dhe bazuar në procesverbalin mbi kundërvajtjen administrative nr.0000013, datë 13.8.2025, të Policisë Bashkiake Shkodër është konstatuar se subjekti Gj.D ka kryer kundërvajtjen administrative, zënie e hapësirës publike që pengon lëvizjen e qytetarëve dhe është sanksionuar në bazë të VKM nr.1, datë 22.1.2016 “*Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Shkodër*”, të ndryshuar me 10. 000 lekë gjobë.

Ndaj subjektit Gj.D , janë vendosur edhe masa të tjera administrative me gjobë gjatë ushtrimit të aktivitetit si ambulant gjatë vitit 2023 dhe 2024, fakt ky që rezulton i provuar bazuar në procesverbalet e konstatimit të shkeljes me numër serie 011275, datë 14.11.2023 dhe numër serie 011579, datë 11.03.2024, respektivisht për ekspozim malli dhe zënie të hapësirës publike.

Në datën 14.8.2025, rezulton se ankuesi A.K i është drejtuar Policisë Bashkiake me një kërkesë nëpërmjet të cilës kërkon të informohet se pse duan t’i prishin objektin.

Objekti/kioska është prishur nga grupi i punës për kontrollin dhe lirimin e hapësirave publike dhe sipas Bashkisë, z. K. , i cili ka pretenduar se është poseduesi i kiosës, ka marrë përsipër pastrimin e vendit (hekur, llamarinë, etj) me qëllim ruajtjen dhe marrjen e tyre nga ana e tij. Sipas bashkisë, ankuesi nuk e ka respektuar këtë marrëveshje me Policinë Bashkiake për pastrimin e vendit, e cila rezulton që të ketë qenë verbale, pasi nuk u administrua ndonjë akt i shkruar për këtë marrëveshje. Në këto kushte, bazuar në procesverbalin mbi kundërvajtjet administrative me nr.serie 0001623, datë 16.08.2025, ankuesi është gjobitur, bazuar në VKB nr.1, datë 22.01.2016 “*Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër*”, të ndryshuar, me 10.000 leke gjobë.

Ankuesi i është drejtuar Komisionerit me ankesën objekt shqyrtimi, duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Bashkisë Shkodër, lidhur me heqjen e kioskës të vendosur në bulevardin “Mehmet Pashë Plaku”, pranë shkollës së mesme “Kol Idromeno”, Shkodër.

Nga faktet dhe rrethat të cilat rezultuar të provuara gjatë shqyrtimit të ankesës, konstatohet se, kioska e cila pretendohet nga ankuesi se i përket atij, ka qenë në shfrytëzim nga ana e një subjekti tjetër, konkretisht Gj.D , me Nipt L57117196O. Kjo e fundit e ka marrë në shfrytëzim hapësirën publike

bazuar në një akt të mëvonshëm, konkretisht kontrata nr.1879 prot., datë 4.2.2022 dhe kontrata me nr.2091 prot., datë 10.2.2023, krahasimisht me ankuesin, i cili e pretendon atë në bazë të shkresës nr.1048 prot., datë 04.04.2011, të lëshuar nga Bashkia Shkodër. Në këto kushte rezulton e provuar se, në momentin që Bashkia Shkodër ka vendosur heqjen e kioskës të vendosur në hapësirën publike, ankuesi nuk ka qenë titullari i cili ka patur të drejtën për të shfrytëzuar këtë hapësirë publike, pra e drejta për të cilën pretendon se është cenuar nga heqja e kioskës nuk i përket atij. Rrjedhimisht në këto kushte ankuesi nuk mund të pretendojë se është cenuar nga sjellja e Bashkisë Shkodër në lidhje me heqjen e kioskës.

Për sa më lart, përfundimisht Komisioneri vlerëson se, ankuesi A.K, nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e Bashkisë Shkodër. Në mungesë të trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar nga ana e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.

Nëpërmjet shkresës nr.6330, datë 04.09.2025, ansuesi i është drejtuar Bashkisë Shkodër me një kërkesë për shfrytëzimin e hapësirës publike/vendosjen e një kioske. Me shkresën nr.17905 prot, datë 10.09.2025, Bashkia i ka kthyer përgjigje duke informuar se kërkesa refuzohet, pasi nuk janë miratuar rregullat, kushtet dhe tipologjitë e kisokave, bazuar në VKB nr.45, datë 25.06.2025.

Me shkresën nr.26223 prot., datë 26.12.2025, Bashkia Shkodër, në përgjigje të kërkesës së bërë nga ankuesi, ka informuar ankuesin se: *“Në lidhje me kërkimin që të shqyrtohen dy gjoba, lutemi që të bashkëlidhni dokumentacionin përkatës për cilat akte/gjoba paraqitni këtë kërkesë sepse me shkresën tuaj nuk gjendet asnjë akt/dokument bashkëlidhur. Në lidhje me kërkesën për kioskën në çdo rast duhet të respektohen kushtet dhe kriteret e përcaktuara në VKB nr.45, datë 25.06.2025 “Për miratimin e rregullores së përdorimit të hapësirës publike në Bashkinë Shkodër”.*

Komisioneri rekomandon Bashkinë Shkodër që në përputhje me kushtet dhe kriteret e miratuara, duke mbajtur në konsideratë se ankuesi është person me aftësi të kufizuara, të vlerësojë me prioritet kërkesën e tij për dhënien e mundësisë së shfrytëzimit të hapësirës publike/kioskë.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit A.K nga ana e Bashkisë Shkodër, për shkak të aftësisë së kufizuar.
2. Rekomandohet Bashkia Shkodër që duke mbajtur në konsideratë se ankuesi A.K është person

me aftësi të kufizuara, të vlerësojë me prioritet kërkesën e tij për dhënien e mundësisë së shfrytëzimit të hapësirës publike/kioskë, në përputhje me VKB nr.45, datë 25.06.2025 “Për miratimin e rregullores së përdorimit të hapësirës publike në Bashkinë Shkodër”

3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Fusha: Të mira dhe shërbime
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim+Rekomandim